



ALBANIAN
FINANCIAL
INTELLIGENCE
UNIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE

RAPORTI VJETOR

2017



Raport Vjetor 2017

PËRMBAJTJA

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	4
SHKURTIMET	6
HYRJE	7
AKTIVITETET KRYESORE	8
Procesi i vlerësimit nga komiteti MONEYVAL i KiE	9
Reforma në Drejtësi dhe procesi i “Vetting-ut”	9
Pjesëmarrja në “Task-Forca” dhe planet e veprimit	10
MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJAE INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRA E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM	11
Raportet e aktivitetit të dyshimtë	12
Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit	15
Urdhrat e bllokimit të përkohshëm	19
TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJ ZBATUESE	20
Tipologji 1	22
Tipologji 2	23
Tipologji 3	24
Tipologji 4	25
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË	26
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	26
Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë	27
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	29
Bashkëpunimi ndërkombëtar	31
Bashkëpunimi rajonal	31
Shkëmbimi i informacioneve me NjIF	31
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE	32
Masat administrative	32
Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore	34
BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	35
Menaxhimi i burimeve njerëzore	36
Teknologjia e informacionit	37
DATAT KRYESORE	38
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018	39



MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të dashur lexues,

Është kënaqësi e veçantë të prezantoj përpara Jush Raportin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Publikimi i këtij raporti është momenti kryesor kur struktura që drejtoj i paraqet publikut të gjerë veprimtarinë e saj, arritjet, problematikat dhe objektivat kryesorë të punës. Si rrjedhim, ky publikim mbart brenda ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies ndaj çdo qytetari, duke bërë të mundur njohjen nga afër me aktivitetin e performancën e DPPPP në kuadër të forcimit të sistemit parandalues në vend, mbrojtjes së sistemit financiar, rritjes së sigurisë dhe luftës pa kompromis ndaj fenomeneve dhe aktiviteteve kriminale që gjenerojnë të ardhura të jashtëligjshme.

Viti që lamë pas ka qenë ndër vitet më dinamike e më intensiv për institucionin tonë, duke na vendosur përballë sfidave dhe detyrave të rëndësishme për të cilat jemi përpjekur maksimalisht ti kryejmë me profesionalizëm, duke synuar të jemi në lartësinë e besimit që na është dhënë dhe duke u fokusuar mbi të gjitha në aspektin cilësor, por pa lënë pas dore atë sasior.

Procesi i vlerësimit të vendit nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, verifikimet për subjektet e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në kuadër të Reformës në Drejtësi, pjesëmarrja aktive në disa Task-Forca e Plane veprimi ndër-institucionale, janë vetëm disa nga angazhimet e veçanta të këtij viti të cilave nuk u ka munguar kryerja me seriozitet dhe profesionalizëm i detyrave funksionale bazë siç janë analizimi i rasteve të dyshimta, shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit me agjencitë ligjzbatuese dhe njësitë homologe, sensibilizimi dhe mbikëqyrja e subjekteve në përputhje me kërkesat e ligjit dhe me standartet ndërkombëtarë të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, etj.

Kjo veprimtari intensive do të vijojë edhe gjatë vitit 2018, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të analizës, finalizimin e procesit të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL, përgatitjen e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve që do dalin nga ky proces, marrjen e masave për zbatimin e tyre, konsolidimin e procesit të përputhshmërisë mbi bazën e riskut dhe rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe organet ligjzbatuese jo vetëm në funksion të punës së përditshme, por edhe në nisjen e punës për vlerësimin Kombëtar të Riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjithë sa u përmend më sipër, por dhe gjithë çfarë synojmë të bëjmë, i dedikohet punës së palodhur e intensive dhe sakrificave të punonjësve të DPPPP, të cilët ndonëse në një numër relativisht të vogël, kanë ditur të përballojnë me sukses dhe të tregohen në lartësinë e kërkesave të kohës.

Në vijim, Ju ftoj të shfletoni këtë material dhe çdo koment e sugjerim në funksion të përmirësimit të tij është mëse i mirëpritur.

Lexim të këndshëm.

ARLIND GJOKUTA

HYRJJE

Raporti i aktivitetit të DPPPP për vitin 2017 paraqet në mënyrë të përmbledhur të dhëna mbi zhvillimet kryesore të saj, në cilësinë e NjIF Shqiptare.



SHKURTIMET

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BE - Bashkimi Evropian
DPD - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DSIK - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
EGMONT - Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
FATF - Grupi i Veprimit Financiar
ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KBLKPP - Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave
KiE - Këshilli i Evropës
MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NjIF - Njësi e Inteligjencës Financiare
OSBE - Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Evropë
PEP - Person i Ekspozuar Politikisht
PP - Prokuroria e Përgjithshme
PP/FT - Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit
PPP/FT - Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit
RAD - Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
RTPF - Raporti i Transaksioneve në Para Fizike
SPAK - Struktura e Posaçme Anti-korrupsion
SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHISH - Shërbimi Informativ Shtetëror
TI - Teknologjia e Informacionit
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKV - Zyrë Këmbimi Valutor
ZQRPP - Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
UNODC - Zyra për Drogën dhe Krimet e Kombeve të Bashkuara

Aktiviteti i këtij viti karakterizohet nga konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe burimeve njerëzore, intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet e përfshira në PPP/FT brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrja në takimet plenare dhe aktivitete të tjera të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës, Grupit EGMONT si dhe të NjIF në rajon.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të DPPPP gjatë vitit 2017, ka qenë angazhimi si në përgatitjen e bazës ligjore e nënligjore në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, ashtu edhe në kontributin konkret për procesin e verifikimit kalimtar të pastërtisë së figurës për gjyqtarët dhe prokurorët.

DPPPP është koordinuese e raundit të V-të të procesit të vlerësimit të vendit nga Komitetit MONEYVAL të KiE, i cili ka kërkuar angazhim të vazhdueshëm dhe koordinim në plotësimin e pyetësorëve. Ky vlerësim kulmoi me vizitën në

vend të grupit të ekspertëve në datat 02-12 tetor 2017. Me anë të këtij procesi është synuar që përveç pasqyrimin tërësor të përafritimit të kuadrit ligjor dhe institucional të vendit me Rekomandimet e FATF, të vlerësojë edhe sa efektiv ka qenë vendi në zbatimin e tyre, përmes 11 “rezultateve imediate”.

Në tërësi, DPPPP ka realizuar objektivat e vendosura për vitin 2017 dhe ka kontribuar në konsolidimin më tej të luftës kundër PPP/FT në vend. Në ushtrim të funksioneve të përcaktuara me ligj, ky vit është karakterizuar nga një aktivitet dinamik dhe shumë planësh, të cilat synojnë forcimin e sistemit parandalues dhe ruajtjen e integritetit të sistemit financiar.

Falë mbështetjes së Qeverisë Shqiptare gjatë vitit struktura e DPPPP u rrit në 39 punonjës nga 28 në vitin 2016. Ky vlerësim dhe besim i qeverisë, buron nga puna me përkushtim e stafit të institucionit dhe roli proaktiv që ka luajtur jo vetëm në luftën kundër PPP/FT, por edhe të krimeve të tjera në fushën financiare.



AKTIVITETET KRYESORE

Viti që kaloi ka qenë sfidues për DPPPP, ku përveç analizimit të rasteve të dyshimta, mbikëqyrjes së subjekteve raportuese, shkëmbimit të informacioneve me NJIF partnere dhe organet ligj zbatuese që përbëjnë aktivitetet thelbësore, institucioni ka pasur rol kyç në procese të rëndësishme si:

- vlerësimi nga Komiteti MONEYVAL;
- verifikimet në kuadër të procesit të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve “Vetting”;
- pjesëmarrja në disa ‘Task-Forca’ me fokus luftën kundër krimit të organizuar dhe narkotikëve.

Procesi i vlerësimit nga komiteti MONEYVAL i KiE

Shqipëria, si një vend anëtar i Komitetit MONEYVAL të KiE, është në proces vlerësimi, në kuadër të raundit të V-të të vlerësimeve të përbashkëta.

Ky Komitet ka për qëllim të sigurojë që anëtarët e tij, të kenë sisteme efektive për PPP/FT në përputhje me standardet dhe konventat ndërkombëtare si: rekomandimet e FATF, konventat e OKB-së dhe KiE lidhur me luftën kundër trafikimit të narkotikëve, terrorizmit dhe financimit të tij, krimit të organizuar, pastrimit të parave etj.

Ky proces ka filluar në vitin 2016 dhe do të vijojë deri në miratimin e raportit përfundimtar gjatë vitit 2018. Ky vlerësim është i një rëndësie të veçantë pasi shërben si pikë referuese për çështjet e PPP/FT nga BE, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe organizma të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë.

DPPPP si institucion koordinues ka luajtur një rol të rëndësishëm në gjithë këtë proces, duke filluar me fazat e hershme përgatitore, përpunimin e kontributeve, organizimin e takimeve, komenteve dhe adresimin e pyetjeve të ndryshme të grupit të ekspertëve. Përgatitjet për këtë proces kërkojnë bashkërendimin e kontributit për mbi 20 institucione dhe vetëm gjatë vizitës në vend janë koordinuar rreth 60 takime me pjesëmarrjen e mbi 200 personave, institucioneve dhe subjekteve private.

Në datën 13.02.2017, nën kryesimin e Kryeministrit u zhvillua Mbledhja e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), në konkludim të së cilës doli dhe Urdhëri i Kryeministrit nr. 1 datë 21.03.2017 ‘Për koordinim e punës të institucioneve publike në funksion të vlerësimit nga MONEYVAL dhe organizma të tjerë të ngjashëm’. Ky urdhër parashikon se DPPPP ka për detyrë të realizojë koordinimin dhe mbledhjen e të dhënave nga të gjitha institucionet publike në kuadër të përmbushjes së Rekomandimeve të FATF.

Pjesëmarrës në takim ishin anëtarët e Komitetit si: Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Mbrojtjes, Zv. Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave, Prokurori i Përgjithshëm, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Zv. Drejtori i SHISH dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI.

Komiteti mori në shqyrtim raportin e DPPPP, mbi efikasitetin e sistemit parandalues dhe zbatimin e legjislacionit penal kundër pastrimit të parave.

Ndër të tjera u miratua dhe ndryshimi i rregullores së vitit 2004 të këtij Komiteti, ndryshime të cilat synojnë koordinimin ndërinstitucional për rishikimin periodik të Vlerësimit Kombëtar të Riskut dhe masave për minimizimin e tij, si dhe sigurimin e përfaqësimit të duhur të vendit në proceset e vlerësimit nga institucione e organizma ndërkombëtarë monitorues.

Reforma në Drejtësi dhe procesi i “Vetting-ut”

Në kuadër të reformës në drejtësi, Vetting-u në sistemin gjyqësor është konsideruar si prioritet për autoritetet Shqiptare dhe për këtë ka pasur mbështetje të pa kufizuar të BE dhe SHBA. Ky proces përfshin vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si në aspektin pasuror ashtu edhe në atë profesional dhe të vendimeve që ata kanë marrë.

Për këtë, roli i DPPPP është i një rëndësie të lartë, duke u përfshirë përmes: verifikimeve dhe kontrolleve të vazhdueshme që janë kryer për një gamë shumë të gjerë personash dhe familjarë të tyre, në kuadër të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, me ngritjen e strukturave të reja, DPPPP përfshihet në: monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve për të gjithë strukturën e SPAK, kryerjen e verifikimeve të transaksioneve për llogari të Prokurorisë së Posaçme, etj.

Konkretisht, gjatë vitit 2017 në kuadër të kërkesave të ILDKPKI, DPPPP ka kryer verifikime në bazën e të dhënave dhe ka kthyer përgjigje brenda 30 ditëve për rreth 3000 persona (prokurorë, gjyqtarë dhe familjarë të tyre), proces ky voluminoz për institucionin, duke marrë në konsideratë se një numër i tillë personash është verifikuar gjatë vitit për llogari të Policisë/Prokurorisë.

Pjesëmarrja në “Task-Forca” dhe planet e veprimit

DPPPP në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë kontribut në kuadër të grupeve të punës të ngritura për detyra të caktuara (Task-Forca), kryesisht për goditjen e aktiviteteve kriminale e krimeve elektorale dhe ka marrë pjesë aktive për hartimin dhe zbatimin e planeve përkatëse të punës.

Në linjë me objektivat e vendosur nga Qeveria Shqiptare për çrrënjosjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, në VKM nr. 248 datë 29.03.2017 “Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017 -2020”, është parashikuar që DPPPP të jetë pjesë e Task-Forcës Qendrore (TFQ) të ngritur për këtë qëllim.

Veprimi proaktiv i DPPPP drejtpërdrejtë në zbatim të këtij plan veprimi konsiston në rritjen e vëmendjes ndaj rasteve të dyshimta që lidhen me përdorimin e parasë fizike, ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese për rritje të vigjilencës për transaksione të mundshme për tu përdorur si instrument i paligjshëm në këtë drejtim, si dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional me organet ligj zbatuese dhe ato të inteligjencës.

Për shkak se viti 2017 ishte vit elektorale, u morën masa në rang kombëtar për parandalimin e financimit të paligjshëm të financimit të partive politike dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre.

Për këtë qëllim u miratua VKM Nr. 473 datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”, në zbatimin e të cilit ishte e përfshirë dhe DPPPP. Në vlerësim të këtij procesi DPPPP ka adresuar kërkesa të posaçme për të gjitha subjektet bankare, e jo vetëm, për rritje të vëmendjes e vigjilencës ndaj transaksioneve të kryera për llogari të partive politike, transaksione të tjera, kryesisht atyre me para në dorë, të cilat mund të kishin synim shitblerjen e votës apo ndaj transaksioneve me anomali në llogari apo në favor të kandidatëve për deputet.

DPPPP ka marrë pjesë në disa takime ndërinstitucionale dhe ka dhënë kontributin e saj për “Për miratimin e Planit të Veprimit për vitet 2017 -2020 për zbatimin e Strategjisë Ndër sektoriale të Luftës kundër krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit” duke u vënë theksi në disa çështje si:

- zgjerimi i aksesit të DPPPP në disa databaza shtetërore;
- nevojën për adresimin dhe marrjen e masave për zvogëlimin e rrisqeve të evidentuara në Vlerësimin Kombëtar të Riskut.

Edhe gjatë 2017, kanë vijuar takimet me Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPPP.

Në këto takime kanë marrë pjesë ekspertë të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Prokurorisë së Përgjithshme, Bankës së Shqipërisë, ILDKPKI, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ndër çështjet kryesore të trajtuara janë: bashkëpunimit ndërinstitucional, ndryshimet në ligjin për PPP/FT, raportimi mbi aktivitetet ndër-kombëtare, vlerësimi kombëtar i riskut të PPP/FT, reforma në drejtësi etj.

MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRAT E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM



Funksionet thelbësore të DPPPP, si NJIF Shqiptare, mbeten mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet ligj zbatuese.

Në përputhje me ligjin për PPP/FT, por edhe me standartet e praktikave më të mira ndërkombëtare, baza e sistemit parandalues janë raportimet transaksionale të dyshimta nga një gamë e gjerë subjektsh raportuese dhe institucioneve shtetërore, nga analizimi i të cilave përcaktohet edhe dërgimi ose jo për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese apo rast pas rasti nxirren edhe urdhra bllokimi të përkohshëm.

Nga analiza e përgjithshme e të dhënave statistikore të paraqitura në vijim, del në pah konsolidimi i mëtejshëm i sistemit parandalues në vend, i cili konsiston në:

- një numër më i lartë i RAD të dërguara nga subjektet e ligjit, krahasuar me vitet e mëparshme;
- rritja e përqindjes së fondeve të sekuestruara nga Prokuroria/Gjykata, në raport me fondet e bllokuara prej DPPPP, çka përbën nivelin më të lartë të arritur në 5 vitet e fundit;
- një numër më i lartë i rasteve për të cilat është kërkuar udhëzime nga subjektet, për të kryer ose jo transaksionet;
- ruajtjen e të njëjtit trend për sa i përket numrit të rasteve të referuara në organet ligj zbatuese.

Raportet e aktivitetit të dyshimtë

RAD e dërguara në DPPPP nga subjektet e ligjit për PPP/FT, siç është përmendur edhe më lart në këtë raport, përbejnë bazën e punës për institucionin. Ndër të tjera, këto raportime evidentojnë një nivel në rritje të njohurive të subjekteve për ligjin dhe ndërgjegjësimin e tyre për masat që duhen marrë.

Gjatë vitit 2017, shënohet rritje prej 7% e numrit të RAD të dërguara nga subjektet raportuese krahasuar me vitin paraardhës, por njëkohësisht është arritur edhe numri më i lartë i RAD të dërguara që prej krijimit të DPPPP.


Tabela 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve raportuese (2013-2017):

Subjekti raportues	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Banka	420	822	585	619	686
Shoqëri transfertash	45	74	79	209	165
DPD	36	48	45	47	46
DPT	10	50	7	3	5
ZQRPP	20	64	210	134	83
Noter	15	122	303	205	254
ZKV	8	16	17	14	20
Shoqëri auditimi	1	0	0	1	0
Ekspert kontabël	1	4	1	0	0
Institucione financiare jo bankë	0	2	0	2	10
Avokat	1	2	0	0	0
Shoqëri të qiradhënieve financiare	0	4	7	15	5
Shoqëri ndërtimit	0	4	1	0	5
Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	0	9	36	35	101
Agjenci udhëtimi	0	0	1	0	0
Shoqëri kursim krediti	0	0	1	0	0
Shoqëri spedicionere	0	0	2	0	0
Shoqëri pagesash elektronike	0	0	19	6	2
Tjetër	1	9	5	2	2
Total	558	1,230	1,319	1,292	1,384

Rritja sasiore e këtyre raportimeve është një tregues domethënës i efektivitetit të DPPPP në drejtim të:

- trajnimeve dhe ndërgjegjësimin të subjekteve raportuese;
- ushtrimit të mbikëqyrjes me bazë risku dhe përqendrim të burimeve në subjektet me risk të mesëm dhe të lartë;
- ndërveprimit me subjektet raportuese, duke përcjellë reagime të ndryshme dhe shpërndarë për ta praktikuar më të mira;
- bashkëpunimit të vazhdueshëm me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese.
- masave administrative të marra në funksion të rritjes së përputhshmërisë ligjore të subjekteve.

Grafiku 1: Ecuria e raportimeve të RAD për periudhën 2013-2017.



RAD e dërguara nga subjektet banka përbëjnë 49.5% të totalit të RAD, vlerë kjo e pritshme duke marrë në konsideratë faktin se bankat janë aktori kryesor në sistemin parandalues në vend, të ndjekur nga noterët me 18.3%, shoqëritë e transfertave me 12% dhe shoqëritë e tregimit të mjeteve motorike me 7.2%.

Nga ana tjetër, duke analizuar këto raportime (RAD) nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre evidentohet se ka rritje të:

- raportimeve të transaksioneve ku ka përfshirje të PEP apo kategori të tjera të konsideruara me risk të lartë;
- raportimeve të transaksioneve në tentativë;
- kujdesit ndaj transaksioneve me para në dorë;
- raportimeve lidhur me kontrata huaje/borxhi.

Tabela vijuese paraqet të dhëna për periudhën 2013-2017 për treguesit kryesorë të cilët kanë shërbyer si indicie për RAD-të.

Të dhënat tregojnë se tipologjitë e RAD ndër vite, kanë ruajtur të njëjtin trend, duke vijuar kështu të jenë edhe indicia më e rëndësishme e rasteve të referuara në organet ligjzbatuese, ku dominojnë: transfertat e dyshimta (si nëpërmjet sistemit bankar edhe nëpërmjet shoqërive të transfertave), derdhjet e larta në para fizike, blerjet e pasurive të paluajtshme/luajtshme me burim të panjohur të fondeve si dhe sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë, etj.

Tipologjitë e këtyre raportimeve janë në një kah me rrisqet e evidentuar në vlerësimin kombëtar të riskut dhe në analizat e ndryshme sektoriale të ndërmarra nga DPPP. Për disa kategori të subjekteve raportuese vërehet zgjerim i fokusit të analizave që ata kryejnë, duke përfshirë jo vetëm transferta të shpeshta dhe në vlera të larta, por edhe raste të dyshimta për transferta të kryera me vende të cilësuar me risk për trafikim të lëndëve narkotike apo të evidentuara në deklaratat publike të FATF dhe raste për përfshirje në transaksione të personave me precedentë kriminal.

Tabela 2: Tipologjitë kryesore të RAD-ve për periudhën 2013-2017.

Subjekti raportues	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Transferta të dyshimta	189	282	351	387	369
Përdorimi i llogarisë individuale për qëllime biznesi/evazion fiskal	44	407	52	14	52
Derdhje me para në dorë në shuma të konsiderueshme	96	112	105	143	190
Veprime jashtë profilit të klientit	60	55	74	95	86
Përfshirje të PEP në transaksione	0	10	4	4	15
Deklarim/Mos deklarim të vlerave në kufi	23	48	21	48	44
Dyshime për financim terrorizmi	4	8	6	29	12
Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë	18	42	102	88	124
Blerje pasurish të paluajtshme me burim të panjohur të fondeve	29	142	421	258	194
Blerje pasurish të luajtshme me burim të panjohur të fondeve	0	16	51	57	120
Mos identifikimi i pronarit përfitues	1	3	0	1	0
Transaksione të mbetura në tentativë	26	23	12	17	34
Transaksione të kryera nga OJF	4	5	11	7	8
Kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv	5	2	1	1	1
Këmbime valutore në vlera të larta	0	10	17	16	17
Përdorimi i instrumenteve bankare me anomali/falsifikuar (letër kredi/çek, etj.)	4	3	0	2	6
Përdorim i dyshimtë i kredive bankare	8	9	10	8	4
Mashtrim/Mashtrim kompjuterik	4	13	5	12	16
Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale	9	15	12	76	45
Dyshime lidhur me aktivitetet të import/eksportit të mallrave	13	0	32	0	0
Transaksione të kryera nga / drejt kompanive të lojërave të fatit	2	3	4	0	2
Tjetër	19	22	28	29	45
Total	558	1,230	1,319	1,292	1,384

Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit

Procesi i analizimit të informacionit mbështetet në përvojën e vyer të krijuar ndër vite në DPPP, por edhe në përvojën dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Evoluimi i këtyre praktikave është mbajtur në vëmendje përmes pjesëmarrjes aktive në takime të ndryshme rajonale e ndërkombëtare, të cilat më pas janë reflektuar në proceset e punës në DPPP.

Dy janë shtyllat kryesore të cilat udhëzojnë analizimin e përpunimin e të dhënave dhe informacioneve që DPPP mbledh:

- Së pari, prioritarizimi i raportimeve dhe informacioneve të marra në bazë të treguesve të dyshimtë dhe nevojës për marrjen e masave të përkohshme të bllokimit;
- Së dyti, ndërveprimi me subjektet raportuese me synimin për të përmirësuar dhe rritjen cilësore të RAD-ve, komunikimin e vazhdueshëm me institucionet ligjzbatuese dhe koordinimin e aktiviteteve për të mundësuar sekuestrimin/ konfiskimin e pasurive dhe ndjekjen penale të personave të përfshirë në aktivitet kriminal.

Fluksi i RAD-ve të dërguara nga subjektet raportuese, i është nënshtruar procesit të analizimit nga DPPP dhe kur janë evidentuar element të dyshimtë për pastrim të produkteve të veprës penale apo financim të terrorizmit, ato janë shpërndarë për agjencitë e zbatimit të ligjit për veprime të mëtejshme hetimore.

Tabela 3: Rastet e referuara në organet e zbatimit të ligjit për periudhën 2013 - 2017

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Referimet në Prokurori	35	148	120	120	131
Referimet në Polici	248	314	281	291	270
Total	283	462	401	411	401


Përveç dërgimit të këtyre informacioneve, DPPP në vijimësi ka pasuruar këto informacione me të dhëna shtesë apo element të dyshimtë, të cilat kanë qenë një vlerë e shtuar për aktivitetin e institucioneve ligjzbatuese dhe kanë kontribuar në procedimet e nisura prej tyre.

Nga analiza e statistikave për vitin 2017, vërehet se ka një rritje të numrit të referimeve në Prokurori, e cila vjen për shkak se DPPP ka arritur të identifikojë veprën mëmë, apo ka patur informacione të tilla të bazuara me indicje që në vlerësimin tonë kërkojnë nisjen pa vonesa të procedimeve penale apo nevojën për sekuestrimin/ konfiskimin e fondeve.

Informacionet dhe analizat për aktivitet të dyshimtë janë dërguar kryesisht në DPPSH, për t'iu nënshtruar plotësisht të tyre me të dhëna shtesë dhe kryerjen e hetimeve në përputhje me parashikimet ligjore, e më tej referimin sipas hapave procedurale në Prokurori.

Informacionet e dërguara në Prokurori kanë pasur një shtrirje gjeografike me mbulim gjithë territorin e vendit, por sigurisht me përqendrim më të lartë në ato rrethe ku edhe zhvillimi ekonomik është më i lartë.

Grafiku 2: Shpërndarja gjeografike e referimeve në Prokurori për vitin 2017



Pamja grafike e shpërndarjes së rasteve të dërguara në Prokurori evidenton se numri më i madh i rasteve është referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor në Tiranë, e ndjekur nga rajonet Vlorë, Elbasan dhe Fier.

Për sa i përket indicjes nga kanë filluar rastet e dërguara në agjencitë ligj zbatuese, rezulton se burim kryesor i tyre mbeten RAD nga subjektet e ligjit, që nënkupton jo vetëm për rritjen e numrit por edhe për përmirësimin e ndjeshëm cilësor të tyre.

Tabela 4: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2017 në Polici/Prokurori

	RAD	Analiza Sektoriale	RTPF	NJIF partnere	Njoftime	Total
Referimet ne Prokurori	105	8	3	1	14	131
Referimet ne Polici	235	7	10	2	16	270
Total	340	15	13	3	30	401

Gjatë procesit të analizimit të rasteve të dyshimta, rëndësi e veçantë i kushtohet identifikimit të mekanizmave të përdorur për kryerjen e pastrimit të produkteve të veprës penale apo financimit të terrorizmit. Në këtë aspekt, përgjatë viteve janë vërejtur kryesisht këto mekanizma veprimi (tipologji), si vijon:

- qarkullim i lartë i pazakontë i fondeve krahasuar me profilin financiar të subjektit;
- derdhje apo tërheqje në vlera të larta dhe të pajustificuara;
- investime të larta në pasuri të paluajtshme me burim të panjohur fondesh;
- transferta të dyshimta (në mbërritje apo në dalje) me përfshirje të subjekteve/shtetasve të huaj dhe të pajustificuara me dokumentacion mbështetës;
- transferta të dyshimta me vende të konsideruara me risk, persona me precedent apo të dyshuar për përfshirje në veprimtari kriminale, pa lidhje të qarta apo të deklaruara mes palëve, etj.;
- huadhënie /huamarrje apo dhurime në vlera të larta të pazakonta mes personave fizikë apo juridikë;
- transaksione financiare të kryera nga persona me precedentë të mëparshëm penalë apo persona të lidhur me ata me precedentë;
- mashtrime të formave të ndryshme;
- mos deklarim i shumave dhe sendeve me vlerë në kufi, etj.

Përveç evidentimit të mekanizmave të përdorur, për një hetim financiar të suksesshëm, është me rëndësi të lartë identifikimi i burimit të fondeve/pasurisë kriminale dhe lidhja e tyre me aktivitetet e jashtëligjshme.

Tabela 5: Të dhëna për klasifikimin e veprës mëmë në periudhën 2013-2017

Vepra mëmë	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Trafikim të lëndëve narkotike	18	50	48	30	43
Trafikim i qenieve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni	4	9	6	7	2
Precedentë të mëparshëm kriminalë	3	15	16	10	8
Krijim / Përfshirje në organizata kriminale	1	-	6	6	5
Financim terrorizmi	1	3	2	8	5
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	17	17	12	17	15
Falsifikim	3	3	8	2	5
Shpërdorim detyre apo korrupsion kryesisht pasiv	7	7	11	9	13
Mos deklarim shumave dhe sendeve me vlerë në kufi	-	4	14	2	1
Dyshime për evazion fiskal	29	40	41	9	16
Vjedhje, grabitje, kanosje, pasojë vrasje	2	12	8	3	7
Trafikim i mjeteve motorike / shmangie detyrime doganore / Kontrabande	3	2	2	4	-
Pastrim parash kur kemi të bëjmë për persona me precedent të tillë apo dyshime për pastrim parash	2	-	4	2	9
Nuk dihet	196	300	224	302	272
Total	286	462	402	411	401

Gjatë vitit 2017, për 33% të rasteve të dërguara në Prokurori/Polici është arritur identifikimi i lidhjes së mundshme me veprimtarinë kriminale të origjinës e cila dyshohet se ka prodhuar fondet e qarkulluara apo të investuara. Numrin më të lartë të rasteve ku ka qenë e mundur të identifikohet vepra mëmë e zënë trafikimi lëndëve narkotike, evazioni fiskal dhe mashtrimet. Vërehet rritje e rasteve të dyshuara për shpërdorim detyre ose korrupsion, të cilat shënuan numrin më të lartë të paktën në 5 vitet e fundit.

Urdhrat e bllokimit të përkohshëm

Për të parandaluar tjetërsimin e produkteve kriminale apo përdorimin e tyre për financim të terrorizmit, në ato raste kur ka fakte e të dhëna të mjaftueshme se një gjë e tillë po ndodh apo mund të ndodhë, DPPPP ushtron të drejtën për bllokimin e përkohshëm prej 72 orësh të transaksioneve dhe pasurive.

Gjatë 2017, janë nxjerrë 52 urdhra bllokimi të përkohshëm kryesisht për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 11.2 milionë EUR, nga të cilat janë sekuestruar me vendim Prokurorie/Gjykate rreth 9 milionë EUR.

Tabela 6: Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2013-2017

Vitet	Nr. i urdhrave të bllokimit	Tot. Bllokuar	Tot. sekuestruar	Raporti sekuestrime/ bllokime
2013	15	881,670	213,500	24.2%
2014	65	18,183,760	13,967,770	76.8%
2015	47	16,278,080	11,266,941	69.2%
2016	61	28,772,733	8,129,000	28.3%
2017	52	11,263,587	9,096,233	80.8%


Siç evidentohet nga të dhënat në tabelë, kemi një rritje të ndjeshme të vlerës së sekuestrimeve në raport me vlerat e bllokuara nga DPPPP. Për vitin 2017 rezultojnë të jenë sekuestruar 80.8% të vlerave të bllokuara nga DPPPP, që përbën nivelin më të lartë të 5 viteve të fundit.

TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJ ZBATUESE

Në kuadrin e rritjes së mëtejshme të kapaciteteve parandaluese të subjekteve të ligjit, në vijim paraqiten disa tipologji të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit të cilat kanë qenë objekt i punës së DPPP.

Tipologji 1

Transferta nga shoqëri të regjistruara në vende para jsa fiskale, në favor të shoqërive ‘call center’ dhe tërheqja e menjëhershme e fondeve



Shoqëria A me objekt veprimtarie ‘call center’, në llogarinë e saj në një nga bankat që operojnë në vend që në fillimet e aktivitetit kishte përfituar disa transferta të dërguara nga vendet e BE, nga shoqëri të regjistruara në vende të parajsës fiskale (i ndryshëm nga vendi i dërgimit të transfertave).

Nga verifikimet e kryera rezultoi se:

Në të njëjtën adresë që ushtronte aktivitetin kompania A, kishin regjistruar selinë edhe disa biznese të vogla të tipit Person Fizik (rreth 11 PF) me të njëjtin objekt veprimtarie si të shoqërisë A dhe të regjistruara në të njëjtën datë në QKB. Këto biznese ishin regjistruar në emër të punonjësve të shoqërisë dhe kishin moshë tepër të re.

Nga analizimi i llogarive të bizneseve PF është vënë re se ka patur transferta në hyrje që në momentin e regjistrimit të tyre nga të njëjtat shoqëri që më parë i kishin dërguar transferta edhe shoqërisë A.

Fondet e mbërritura në llogaritë e bizneseve PF ishin pothuajse në të njëjtat vlera (10,000-15, 000 EUR për transfertë) dhe të gjitha këto fonde tërhiqeshin menjëherë nga shtetasi Z, i cili ishte person i autorizuar për kryerje transaksionesh në bizneset PF si dhe njëkohësisht i punësuar menaxher në shoqërinë A.

Gjatë analizimit të mëtejshëm të rastit është konstatuar se shoqëritë dërguese, jashtë vendit kanë qenë të lidhura me shoqëri të tjera në Shqipëri me veprimtari ‘call center’ të sapo krijuara dhe me ortak shtetas me moshë të re, raste për të cilat është dërguar informacion kohë më parë në organet ligj zbatuese për dyshime lidhur me aktivitetin që ato ushtrojnë.

Bazuar në dyshimet se:

- fondet e përfituara në llogari të bizneseve të sapokrijuara tërhiqen me para në dorë nga një person i autorizuar, shtetasi Z i cili është i punësuar në shoqërinë A;
- vendi i dërgimit të fondeve i ndryshëm nga ai selisë së shoqërive dërguese;
- përfitimi i disa transfertave në vlera të konsiderueshme për një periudhë të shkurtër kohore;
- krijimi i disa bizneseve në të njëjtën datë me të njëjtën adresë dhe objekt veprimtarie.

DPPP ka informuar organet e zbatimit të ligjit për investigim të mëtejshëm të rastit.

Tipologji 2

Transferta të kryera me vende të Amerikës Latine nga shtetas me lidhje familjare me persona të dënuar për trafikim lëndësh narkotike


Për një periudhë 2-vjeçare shtetasi A kishte përfituar transferta të shumta nga shtetas të ndryshëm nga një vend në Amerikën Latine, shteti N, por ajo që binte në sy ishte se për një periudhë 6 mujore (në 2014) shtetasi A kishte dërguar edhe rreth 20 transferta në vlerë totale 82,000 EUR drejt shtetasve të ndryshëm në këtë shtet.

Lidhjet ndërmjet shtetasit A dhe shtetasve dërgues/përfitues ishin të paqarta, transfertat ishin me vende me risk lidhur me trafikimin e lëndëve narkotike, për rrjedhojë rasti u dërgua për verifikime të mëtejshme në organet ligj zbatuese.

- Vëllai i shtetasit A si dhe bashkëshortja e shtetasit A (shtetasja B) kishin dërguar një numër të konsiderueshëm transfertash drejt vendit N për një periudhë rreth 2- vjeçare.
 - transfertat ishin kryesisht në vlerat 200-1,000 EUR, por kishte edhe transferta në vlera të ulëta deri në 20 EUR/transferta;
 - dërgesat ishin të shpeshta 18-20 transferta në muaj dhe në favor të shtetasve të ndryshëm.

Nga verifikime të tjera të kryera në lidhje me të afërm të ngushtë të bashkëshortes së shtetasit A, për vëllain dhe të atin e saj rezultoi:

- Shtetasi X, (babai i shtetasës B) kishte përfituar në shtetin N disa transferta të dërguara nga Shqipëria.
 - shtetasi X nga burime të hapura rezultonte të ishte i arrestuar më parë për trafikim lëndësh narkotike.
- Shtetasi Y (vëllai i shtetasës B):
 - rezultonte të ishte arratisur nga ambientet e paraburgimit, pasi ishte dënuar me 25 vjet për vrasje të një punonjësi policie;
 - ishte arrestuar në një shtet jo Evropian për vjedhje dhe trafikim lëndësh narkotike;
 - ishte arrestuar në shtetin N, pjesë e një grupi trafikimi lëndësh narkotike.



Tipologji 3

Qarkullimi i shumave të dyshimta në sistemin bankar


Shtetasi A zotëron llogari personale në një bankë të nivelit të dytë që prej 2015 dhe në vitin 2017 i ka mbërritur një transfertë nga shoqëria X nga një vend i BE në vlerë 310,000 USD, për të cilën ka kërkuar tërheqjen e shumës pa dhënë asnjë informacion lidhur me burimin e fondeve, dërguesin e tyre apo qëllimin e dërgimit.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se:

- shoqëria X që ka dërguar transfertën e mësipërme është një nga aksionerët e shoqërisë Y, e regjistruar në Shqipëri, me të cilën shtetasi A ka marrëdhënie biznesi pasi e furnizon me karburant, dhe për shkak të kësaj marrëdhënie, ka kërkuar një hua në vlerë 310,000 USD për investim në biznes;
- nga të dhënat e QKB, shtetasi A është aksioner në katër shoqëri, të cilat operojnë në të njëjtën fushë veprimtarie;
- gjatë periudhës që shtetasi A është përfshirë në këto subjekte (2011-2017) ka qarkulluar një numër të konsiderueshëm transaksionesh bankare në vlera të larta, veprime të cilat kanë kryesisht natyrë biznesi;
- nga një informacion në burimet hapura, ky shtetas është arrestuar me akuzën e mashtrimit.

Informacioni i analizuar është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit, nga të cilët na është konfirmuar se shtetasi A figuron i evidentuar me precedent kriminal për veprën penale “Mashtrim” dhe është caktuar masa e sigurisë “Arrest në burg”.

Bazuar në këto indicie DPPP ka nxjerrë urdhër bllokimi. Në vijim është regjistruar një procedim penal ndaj këtij shtetas si dhe është vendosur sekuestrimiti i shumës 310,000 USD.



Tipologji 4

Të ardhura të siguruara nga aktiviteti i jashtëligjshëm

04

Shtetasja A ka depozituar në një bankë të nivelit të dytë shumën 80,000 EUR duke deklaruar të ardhura nga emigracioni.

Ndërkohë në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën bankë, shtetasi X (dhëndri i shtetasës A) ka hapur llogari të përbashkët me bashkëshorten e tij shtetasen B, ku ka depozituar shumën 65,000 EUR si kursime familjare dhe puna në emigracion në një vend të BE. Në lidhje me këto depozitime nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues.


Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se:

- shtetasja B ka investuar në pasuri të paluajtshme në vlerën prej 150,000 EUR;
- nuk kanë biznes të regjistruar në QKB.

Në lidhje me shtetasin X kemi kërkuar informacion në organet e zbatimit të ligjit dhe në vijim jemi informuar se shtetasi X dhe B janë të dyshuar nga autoritetet e një vendi të BE, vendi M si persona të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike.

Nga informacioni i marrë nga banka rezulton që më pas shtetasi X i përfaqësuar me prokurorë nga shtetasja A ka kryer një transfertë prej 70,000 EUR në shtetin M për blerje shtëpie.

Pas këtij informacioni materialet janë referuar në organet e zbatimit të ligjit, është nxjerrë urdhër bllokimi për rastin dhe më pas jemi informuar se është nxjerrë edhe urdhër sekuestrimi.



NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË

Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i subjekteve raportuese nuk është konsideruar vetëm si një detyrim ligjor për DPPPP, por si një proces i rëndësishëm dhe shumë dimensional, proces i cili është i lidhur ngushtësisht me cilësinë e sasinë e raportimit të rasteve të dyshimta, por edhe me bashkëpunimin e vijueshëm, përcaktues për suksesin ose jo të rasteve të analizuara dhe dërguara për agjencitë ligjzbatuese.

Tabela 7: Nr. i personave të trajnuar në subjekte për periudhën 2013 – 2017.

Subjekti	Nr i personave të trajnuar				
Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Banka të Nivelit të dytë	84	120	285	108	364
Zyra Këmbimi Valutor	151	70	73	77	35
Institucione jo bankë	0	68	115	188	115
Lojëra Fati	15	12	0	6	3
Noterë	75	237	73	127	30
Ekspert Kontabël	63	1	0	1	3
Shoqëri Sigurimi	0	0	35	1	1
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione (AMF, ZQRPP, DPPSH, DPD, DPT)	13	139	58	108	27
Shoqëri tregtimi të automjeteve	0	14	0	3	3
Organizata jofitimprurëse	0	0	45	0	0
Shoqëri Ndërtimi	0	38	0	8	14
Institute të Pensioneve Private	0	0	5	1	1
Totali	401	699	689	628	596



Gjatë vitit 2017, prioritare në numrin e personave të trajnuar kanë qenë subjektet financiare, kryesisht bankat. Tematikat kryesore të diskutuara në këto trajnime kanë qenë:

- detektimi dhe analizimi i transaksioneve me tregues anomalie të lidhura me partitë politike;
- intensifikimi i analizimit të transaksioneve dhe aktivitetit të klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- rritja e vëmendjes për transaksionet me para në dorë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe veçanërisht trafikimit të lëndëve narkotike dhe jo vetëm;
- masat kundër financimit të terrorizmit, sanksionet ndërkombëtare për personat e shpallur si terrorist;
- hartimi/rishikimi i vlerësimeve të rrisht nga subjektet raportuese dhe masat për adresimin e risqeve të evidentuar në dokumentin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut.

Në fokus të takimeve dhe rritjes së ndërgjegjësimit për rolin e tyre kanë qenë edhe autoritetet të cilat licencojnë dhe mbikëqyrin subjektet e ligjit për PPP/FT, të cilat janë informuar mbi problematikat e hasura nga DPPPP dhe nevojën për rritjen e bashkëpunimit me qëllim forcimin e sistemit parandalues në vend.

Në tablonë e këtyre trajnimeve është evidentuar përdorimi i pasurive të paluajtshme si tipologji për pastrimin e parave, ku është kërkuar veçanërisht nga ZQRPP rritja e shkallës së vigjilencës në identifikimin e

anomalive në transaksionet e shkëmbimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme apo ri-vlerësimit të tyre.

Në vëmendje të DPPPP, ka qenë shpërndarja e praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare, për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të mundësuar rritjen e shkallës së njohurive të subjekteve të ligjit mbi rolin e tyre në sistemin parandalues.

Përveç pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme trajnimi/sensibilizimi, gjatë procesit të inspektimit në vend të 63 subjekteve, këto të fundit janë trajnuar në mënyrë të posaçme, duke lënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së tyre për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Njëkohësisht, nisur nga mangësitë e vërejtura prej monitorimit në distancë, janë udhëzuar në rrugë elektronike subjektet e ligjit për saktësinë e raportimeve dhe ndërgjegjësimit të tyre për informacionin që dërgojnë.

Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë

Një ndër funksionet kryesore të DPPPP është mbikëqyrja e përputhshmërisë së subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ky funksion realizohet me anë të inspektimeve në vend dhe në distancë, shqyrtimit dhe analizimit të raportimeve të subjekteve, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse.

Në kuadër të vlerësimit sa më adekuat të nivelit të përputhshmërisë, mbikëqyrja bëhet bazuar në kategorizimin e subjekteve të ligjit, sipas nivelit të riskut për PPP/FT duke pasur në fokus ato kategori, të cilat janë të ekspozuara në një shkallë më të lartë ndaj pastrimit të produkteve të veprës penale.


Për vitin 2017, nga ana e DPPPP është intensifikuar puna për orientimin e subjekteve të ligjit, veçanërisht të institucioneve financiare drejt vlerësimit individual të riskut për PP/FT në lidhje me klientët e tyre, kategorinë e shërbimeve që ofrojnë etj., për të forcuar dhe konsoliduar më tej strukturat e tyre parandaluese.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese ka vijuar të jetë me rëndësi prioritare dhe në këtë kontekst janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta në subjektet financiare, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Tabela 8: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2013-2017.

Nr.	Subjektet e inspektuara	Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
1	Banka	7		7		6	7	9		5	2
2	Institucione Fin. Jo-bankë			3	1	7	2	9		5	
3	Shoqëri Brokerimi									1	
4	ZKV	2	110	19	8	22	6	12	1	18	27
5	Ekspertë kontabël		27	3	16	5	1	1	1	3	9
6	Shoqëri ndërtimi		10	18		15	7	8	14	14	19
7	Mjete motorike			8	1			3	1		5
8	Noterë	1	19	4	67	13	1	21	28	6	17
9	Lojëra Fati			3			8	6		3	3
10	Sigurim jete dhe ri-sigurim			1		2		1		1	
11	Studio Ligjore					3					15
12	Shoq. administrimi & tregtimi të letrave me vlerë						4				
13	SHKK						4	2		1	
14	Shoqëri Transporti					1					
15	Vepra Arti					1					
16	Metale të çmuara			3						1	
17	Imobiliare		8	2				4		3	5
18	Fonde Investimi/Pensioni							1		1	
19	Agjenci Udhëtimi			1						1	6
	Shuma	10	174	72	93	75	40	77	45	63	108
	Totali	184		165		115		122		171	

Tabela 8: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2013-2017.



Gjatë këtij viti ka marrë përparësi mbikëqyrja në distancë ku përkundrejt numrit total të 171 inspektimeve të realizuara, 108 prej tyre janë vlerësime dhe shqyrtime të raporteve të vetëkontrollit, që u dërgohen periodikisht subjekteve. Duke konsideruar burimet e kufizuara në dispozicion DPPP ka përdorur inspektimin në distancë si një mjet efektiv për vlerësimin e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve të ligjit. Në tërësi kemi një rritje të subjekteve të inspektuara me rreth 40% krahasuar me një vit më parë.

Përqendrimi i inspektimeve ka qënë kryesisht në subjektet e vlerësuar me risk të mesëm ose të lartë, kështu në 70% të inspektimeve të kryera janë përzgjedhur kategori të subjekteve me nivel risku të mesëm ose të lartë.

Gjatë procesit të analizës së përputhshmërisë për vitin 2017 janë evidentuar disa mangësi të subjekteve kryesisht si më poshtë:

- mos raportimi i transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj;
- mos ushtrim i masave të “Vigjilencës së zgjeruar” për kategoritë e klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- nuk është kryer monitorim i marrëdhënies së biznesit me klientin;
- nuk është mbajtur një sistem i centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- mos kryerja e analizave për transaksionet komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe të pa justifikuar nga pikëpamja ekonomike;
- mos identifikimi i klientëve dhe mos ruajtja e këtyre dokumenteve në përputhje me parashikimet ligjore;

Për këto mangësi, DPPP ka vijuar procesin e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, ka lënë rekomandime për përmirësimin e situatës në subjekt dhe njëkohësisht ka vënë në dijeni autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese.

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional

Arritjet në goditjen e fenomeneve të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit do të ishin të pamundura pa një bashkëpunim dhe koordinim të një numri të lartë të institucioneve të përfshira, NjIF partnere, por edhe të subjekteve private.

DPPP ka qënë e angazhuar maksimalisht në rolin e saj si NjIF, për të siguruar një mbështetje të vyer veçanërisht për Policinë dhe Prokurorinë.


Kështu, përveçse informacionet e dërguara nga DPPP në këto institucione janë një bazë solide për punën e tyre dhe bëjnë pjesën dërrmuese të rasteve të hetuara apo proceduara për pastrim parash, kemi mundësuar vetëm gjatë vitit 2017 informacion për rreth 3700 persona/subjekte bazuar në kërkesat e Policisë dhe Prokurorisë.

Tabela 9: Të dhëna për kërkesat e ardhura nga Policia/Prokuroria për periudhën 2013 - 2017

Vitet	Polici		Prokurori		Total	
	Nr. kërkesa	Nr. persona/ subjekte	Nr. kërkesa	Nr. persona/ subjekte	Nr. kërkesa	Nr. persona/ subjekte
2013	79	726	192	1162	271	1888
2014	122	647	250	1920	372	2567
2015	154	765	149	1010	303	1775
2016	308	1415	180	1135	488	2550
2017	321	2497	259	1198	580	3695

Nga të dhënat e mësipërme lehtësisht evidentohet që për vitin 2017 ka rritje të theksuar me 26% të informacioneve që DPPP u ka mundësuar këtyre institucioneve. Në 5 vitet e fundit është vënë në dispozicion informacion për 12,475 persona/subjekte, punë që ka kërkuar angazhim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm të stafit dhe burimeve të institucionit.

Grafiku 4: Kërkesat për informacion nga Policia / Prokuroria për periudhën 2013-2017.



Gjatë këtij viti, përveç shkëmbimit të informacionit me Policinë dhe Prokurorinë, DPPPP ka vijuar zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ILDKPKI në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, duke trajtuar e kthyer përgjigje për 181 kërkesa ku janë përfshirë 677 persona/subjekte.

Mbështetur në këto të dhëna nënvizojmë që për vitin 2017 nga DPPPP, janë kryer verifikime dhe kthyer përgjigje për 4,372 persona/subjekte për agjencitë si: Policia, Prokuroria dhe ILDKPKI.

Ndërkohë, falë punës së jashtëzakonshme dhe angazhimit të një pjese të madhe të stafit të DPPPP, është arritur që në kohë rekord brenda një muaji, të përfundojë

në kuadër të procesit të ‘Vetting-ut’ në sistemin gjyqësor verifikimi i afro 3000 persona/subjekte.

Këto të dhëna tregojnë për një rritje me mbi 350% të flukseve të informacionit që DPPPP ka mundur për agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet e tjera. Kështu, për vitin 2017 janë 7,372 persona/subjekte të verifikuara, krahasuar me mesataren prej 2,094 të 5 viteve të mëparshme.

DPPPP ka pasur bashkëpunim të frytshëm me SHISH në kuadër të orientimit të fushave reciproke të veprimtarisë, për mbrojtjen e sistemit financiar në tërësinë e vet, luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e radikalizmit e financimit të terrorizmit.

Rëndësi i është kushtuar edhe bashkëpunimit me DPD dhe DPT. Janë adresuar në mënyrë të pandërprerë çështje që

kanë të bëjnë me PPP/FT si:

- përmirësimi dhe rritja cilësore/sasiore e RAD-ve;
- rritja e shkëmbimeve të informacioneve me DPT në kuadër të mbikëqyrjes ndaj OJF-ve;
- forcimi dhe koordinimi i aktiviteteve për të ulur nivelin e riskut që vjen nga përdorimi apo transportimi i parasë fizike;
- rrisqet që paraqet pastrimi i parave duke përdorur instrumentet e tregtisë siç është importi/eksporti me çmime fiktive.

Në përpjekje për të zgjeruar bazën e institucioneve me të cilat DPPPP bashkëpunon dhe me qëllim rritjen e burimeve të informacionit, në korrik 2017, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjellët, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit konkret dhe të frytshëm në funksion të parandalimit e luftës kundër korrupsionit e pastrimit të parave, ose aktiviteteve të lidhura me to.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

DPPPP është angazhuar rregullisht në aktivitetet e Grupit EGMONT të Njësisë të Inteligjencës Financiare (NjIF). Në këto aktivitete, janë diskutuar ndër të tjera, sfidat me të cilat përballen njësitë e inteligjencës financiare në botë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, problematikat në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të informacionit apo krijimi i Qendrës së Grupit EGMONT për përsosmëri dhe udhëheqje për NjIF (ECOFEL), etj.

Bashkëpunimi rajonal


Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal, në Nëntor 2017, u organizua në Slloveni takimi vjetor i NjIF të rajonit. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të NjIF nga Bosnje - Hercegovina, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Sllovenia dhe Shqipëria. Gjatë këtij takimi janë diskutuar dhe shkëmbyer eksperiencat për sa i përket tipologjive dhe trendeve të reja për PP/FT, ndryshimet e nevojshme ligjore në kuadër të proceseve të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL etj.

Shkëmbimi i informacioneve me NjIF

Bashkëpunimi i DPPPP me njësitë homologe, anëtare të Grupit EGMONT, në kuadrin e shkëmbimit të inteligjencës financiare ka ardhur gjithnjë në rritje, duke u intensifikuar sidomos me NjIF të Britanisë së Madhe, Greqisë, SHBA-së, Italisë, Belgjikës, Malit të Zi, Holandës dhe Kosovës.

Shkëmbimi i informacionit me homologët përpos kërkesave të dërguara apo kthimit të përgjigjeve, ka shërbyer edhe si indicie për detektim dhe dërgimin e rasteve të dyshimta në organet ligj zbatuese.

Grafiku 5: Të dhëna mbi shkëmbimin e informacionit me NjIF homologe për periudhën 2013-2017



Siç vihet re nga grafiku më sipër, shkëmbimi i informacionit me NjIF ka ardhur në rritje për vitin 2017. DPPPP i ka kushtuar rëndësi përdorimit të këtij instrumenti, ku për vitin 2017 janë bërë 74 kërkesa, kundrejt 42 të një viti më parë, apo krahasuar me mesataren prej 50 kërkesash për periudhën 2013-2016.

Ndërkohë, kërkesat e ardhura nga homologët kanë ruajtur të njëjtin trend.

MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE

Masat administrative

Në kuadër të mbikëqyrjes së vazhdueshme që DPPPP ushtron për subjektet e ligjit për PPP/FT, në ato raste kur janë konstatuar kundërvajtje administrative, subjektet janë dënuar me gjobë sipas nivelit të shkeljeve të kryera.

Për vitin 2017, në përfundim të procesit të analizimit të përputhshmërisë me detyrimet ligjore, janë mbledhur dhe administruar provat dhe faktet mbi të cilat janë proceduar administrativisht dhe dënuar me gjobë 26 subjekte.



Tabela 10: Numri dhe vlera e gjobave (në LEK) sipas llojit të subjekteve të proceduara (2013-2017).

Subjekte	Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017	
	Nr. i masave	Vlera e gjobave	Nr. i masave	Vlera e gjobave	Nr. i masave	Vlera e gjobave	Nr. i masave	Vlera e gjobave	Nr. i masave	Vlera e gjobave
Banka të Nivelit të Dytë	2	8,500,000	5	4,430,000	2	6,000,000	5	10,700,000	5	17,000,000
Zyra Këmbimi Valutor	6	5,700,000	7	4,300,000	8	6,800,000	5	3,500,000	8	3'600'000
Noterë	5	1,700,000	29	9,700,000	4	2,700,000	11	3,400,000	2	1,000,000
Institucione Jo Bankë	0	0	2	800,000	3	2,200,000	2	1,000,000	1	500,000
Lojëra Fati	0	0	3	2,500,000	0	0	4	3,600,000	1	500,000
Shoqëri Ndërtimi	0	0	11	6,800,000	15	14,700,000	4	3,800,000	9	6,000,000
Agjenci udhëtimi	0	0	0	0	1	300,000	0	0	0	0
Shoqëri Sigurim Jete	0	0	0	0	1	2,000,000	0	0	0	0
Shoq. treg. mjet. motorik	0	0	0	0	0	0	2	4,000,000	0	0
TOTALI	13	15,900,000	57	28,530,000	34	34,700,000	33	30,100,000	26	28,600,000

Pas shqyrtimit të raporteve të përputhshmërisë të përgatitura nga strukturat përkatëse dhe ballafaqimit me qëndrimet kundërshtuese të subjekteve raportuese, shkeljet kryesore për të cilat ato janë dënuar, janë si më poshtë:

- mos zbatim i detyrimit për identifikimin e klientëve dhe ruajtjen e dokumenteve të identifikimit;
- mos zbatim i detyrimit për monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit dhe mbledhjen e të dhënave për burimin e fondeve;
- mos zbatim i detyrimit për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të centralizuar për grumbullimin dhe analizimin e transaksioneve;
- mos zbatim i detyrimit për raportimin e transaksioneve në para fizike.

Totali i vlerës së masave administrative të vendosura për vitin 2017 është 28.6 milion LEK, ku peshën kryesore e zënë bankat ndaj të cilave janë aplikuar 5 masa me vlerë 17 milion LEK, të ndjekura nga shoqëritë e ndërtimit, ndaj të cilave janë vendosur 9 masa me vlerë totale 6 milion LEK. Minimumi i gjobës së vendosur është 300,000 LEK dhe maksimumi 5,000,000 LEK.

Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore

Vendosja e masave administrative është e pritshme që nuk do të jepte efektet e duhura korigjuese nëse nuk do të ndiqeshin deri në ekzekutimin përfundimtar të tyre. Në pjesën dërmuese të tyre masat administrative të vendosura nga DPPP janë ekzekutuar vullnetarisht.

Tabela 11: Të dhëna për arkëtimet për periudhën 2013-2017

Zërat	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Vendime për Gjoha	13	57	34	33	26
Shuma totale e gjobave LEK	15 900 000	28 530 000	34 700 000	30 100 000	28 600 000
Shuma totale e arkëtimit LEK	16 661 000	34 235 705	17 656 000	31 786 000	27 788 000

Për të rritur efikasitetin e masave administrative, DPPP ka ndjekur në vijimësi fazat e ekzekutimit dhe ka kërkuar informacion nga zyrat përmbarimore për statusin dhe fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Përveç ekzekutimit vullnetar të masave administrative, ka subjekte të cilat kundërshtojnë vendimet në gjykata dhe për këtë DPPP i jep rëndësinë e duhur ndjekjes së këtyre proceseve ku është e përfshirë si palë.

BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Buxheti dhe menaxhimi i tij


Menaxhimi i fondeve buxhetore të akorduara për DPPP është bërë me efikasitet, në përputhje të plotë me detajimin e buxhetit sipas programit buxhetor dhe legjisllacionin në fuqi. Gjithashtu, janë hartuar pasqyrat financiare dhe periodikisht është raportuar në mënyrë të detajuar për realizimin e prokurimeve publike dhe objektivave të vendosura.

Gjatë vitit 2017, fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit janë në shifrën 64,750,000 LEK të ndara në:

- shpenzime korrente në vlerë 61,750,000 LEK të realizuara në masën 82%;
- shpenzime kapitale në vlerë 3,000,000 LEK të realizuara në masën 94.8%.

Në grafikun vijues paraqiten të dhëna në lidhje me realizimin fondeve buxhetore në dispozicion ndër vite.

Grafik 6: Realizimi i fondeve sipas zërave të buxhetit gjatë 2017



Menaxhimi i burimeve njerëzore


Për një organizim dhe funksionim sa më efektiv dhe eficient, në plotësimin e objektivave të Drejtorisë të bazuara dhe në politikat prioritare të Qeverisë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është kërkuar me insistim dhe në mënyrë të vazhdueshme një ndryshim në rritje në numrin e personelit të DPPP.

Në vijim, me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 46, datë 12.04.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” personeli është shtuar me 11 punonjës, duke e çuar numrin total në 39.

Kjo shtesë në numër të punonjësve është në përputhje me rritjen e ngarkesës në punë në çdo drejtim si: rritja e numrit të RAD-ve që duhen trajtuar, rritja e numrit të kërkesave nga institucionet bashkëpunuese shtetërore, rritja e frekuencës së inspektimeve të subjekteve raportuese dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore në funksion të zbatimit të reformës në drejtësi.

Ndonëse struktura e re e DPPP u miratua në muajin prill 2017, për shkak të pezullimit të rekrutimeve gjatë fushatës zgjedhore, u bë e mundur që procedurat për pranimin e punonjësve të rinj të finalizohen vetëm në fund të vitit.

Organigrama e DPPP



DPPP ka mundur rritjen profesionale të stafit dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga KiE, UNODC, OSBE etj.. Konkretisht për 2017, 13 punonjës të DPPP kanë qenë pjesëmarrës në 15 trajnime ku temat kryesore

që janë trajtuar kanë qenë: ‘Teknikat e hetimit financiar’, ‘Gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i Aseteve’, ‘Udhëzime dhe indikator për parandalimin e krimit kibernetik’, ‘Metodat dhe teknikat analitike për investigimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, ‘Trafikimi i qenieve njerëzore’ etj.;

Teknologjia e informacionit

Rritja e kapaciteteve të Teknologjisë e Informacionit ka vijuar të jetë një nga aspektet prioritare të punës së DPPP gjatë vitit 2017. Në këtë kontekst rëndësi të dorës së parë ka pasur plotësimi i vendeve vakante të përgjegjësive dhe specialistëve të Sektorit të TI, planifikimi i kërkesave për pajisje dhe realizimi në kohë i procedurave të prokurimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i subjekteve raportuese dhe shkëmbimi i sigurtë i informacionit.


Sigurimi i mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së informacionit është realizuar në vijimësi në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të specialistëve të TI në DPPP, me kolegët e tyre në DSJK. Në këtë kuadër një vëmendje e veçantë i është kushtuar plotësimit të rekomandimeve përkatëse për çështjet e sigurisë, të cilat shërbejnë si bazë për planifikimin në vijimësi të nevojave dhe trajnimin për fusha specifike.

Bashkëpunimi ndërinstitucional me DPPSH, SHISH dhe DPD ka qenë një tjetër element i rëndësishëm i punës së DPPP, duke synuar shkëmbimin në kohë dhe brenda parametrave të sigurisë të informacionit për çështje PPP/FT.

Të dhënat që raportohen nga subjektet e ligjit, zënë peshën kryesore të informacionit që mbledh dhe përpunon DPPP dhe për këtë qëllim është punuar pa reshtur, për të realizuar funksionimin normal të moduleve të raportimit duke ofruar një mbështetje të vazhdueshme teknike për këto subjekte si dhe për përdoruesit e një sërë institucionesh shtetërore.

Bashkëpunimi i DPPP në nivel ndërkombëtar, ka diktuar nevojën e sigurimit të mbarëvajtjes së funksionit të mekanizmave të shkëmbimit të sigurtë të informacionit me NjIF partnere, në funksion të të cilit është realizuar një mbikëqyrje e vazhdueshme në përputhje me standardet dhe praktikat ekzistuese të grupit EGMONT.

Mjetet e komunikimit elektronik janë përdorur gjerësisht për të informuar kategori të caktuara të subjekteve të ligjit, për çështjet që janë çmuar me risk të mesëm ose të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, në përputhje dhe me praktikën tashmë të konsoliduar në DPPP nga vitet pararendëse.



DATAT KRYESORE

- Në maj të vitit 2000, Parlamenti Shqiptar, pas kërkesave të ripërsëritura të Këshillit të Europës dhe të Komitetit MONEYVAL, miratoi Ligjin nr. 8610 datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”;
- Në gusht të vitit 2001, krijohet për herë të parë Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave;
- Në korrik të vitit 2003, Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë bëhet anëtare me të drejta të plota në Grupin EGMONT, gjatë sesionit plenar të mbajtur në Australi;
- Në gusht të vitit 2005, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave ngrihet në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave;
- Në nëntor të vitit 2006, u miratuan ligjet nr. 9641, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Parandalimin e Terrorizmit” dhe nr. 9646, datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe të Financimit të Terrorizmit”;
- Në maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i cili hyri në fuqi në shtator të po atij viti;
- Në tetor të vitit 2009, me Vendimin nr. 1077, datë 27.10.2009, të Këshillit të Ministrave, u miratua Dokumenti Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”, në hartimin e të cilit DPPPP kishte rol drejtues;
- Në prill 2011, Komiteti MONEYVAL i KiE miratoi raportin e raundit të 4-t për Shqipërinë, ku pasqyrohet vlerësimi në rritje për Rekomandimin 26 të FATF dhe që lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e DPPPP si Njësi e Inteligjencës Financiare;
- Në tetor 2012, përfundoi dhe iu paraqit KBLKPP dokumenti për Vlerësimin Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
- Në muajin tetor 2013, Parlamenti Shqiptar, miratoi ligjin Nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Në maj 2015, Shqipëria përmbylli procesin e realizimit të rekomandimeve të FATF dhe hiqet nga lista publike e vendeve me mangësi në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në qershor 2015, përfundoi rishikimi i vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT, dokument i cili iu është shpërndarë institucioneve dhe autoriteve përkatëse;
- Në shtator 2015, Komiteti MONEYVAL i KiE mori në shqyrtim progresin e bërë nga vendi ynë në drejtim të rekomandimeve të raundit të IV të vlerësimit dhe bazuar në masat e ndërmarra nga autoritetet, vendosi ndërprerjen e procedurës së mbikëqyrjes së përfortuar;
- Në nëntor 2016, me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratua me procedurë të brendshme shpallja e listës së personave si terroristë.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018

Përpjekjet dhe puna e bërë gjatë vitit 2017 do të shërbejë si pikënisje për çuarjen më tej të objektivave të vendosura në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mbetemi të angazhuar për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, rregulloreve dhe procedurave si dhe proceseve të punës së DPPPP.

Përveç objektivave ligjore të DPPPP që janë pjesë e detyrave funksionale të institucionit, gjatë vitit 2018 vëmendje të posaçme do të ketë:

- fillimi i procesit të rishikimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut;
- konsolidimi i procesit të përputhshmërisë mbi bazën e riskut dhe bashkërendimi i punës me autoritetet mbikëqyrëse;
- forcimi i kapaciteteve të TI;
- ndjekja dhe koordinimi i procesit të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga ky vlerësim;
- kontributi në për procesin e ‘Vettingut’ për Policinë.



ADRESA :

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
“BULEVARDI DËSHMORET E KOMBIT”,
NR. 3 TIRANE, SHQIPËRI



KONTAKTE :

T: +355 4 2244602
F: +355 4 2244602
M: public.relations@fint.gov.al
W: www.fint.gov.al